REVISTA E KOMUNITETIT SHQIPTAR NE BRITANINE E MADHE - MAGAZINE FOR THE ALBANIAN COMMUNITY IN THE UK AND REPUBLIC OF IRELAND

ALBANIAN POST

Nr. 10

QERSHOR / JUNE 2019

Editor in Chief: Dr. Fatmir Terziu - **Telephone:** 07984497444 - mail@albanianpost.co.uk - www.albanianpost.co.uk - www.fjalaelire.com

21 Komunitet...

14 Biznesmeni Agron Kurtaj...

18 Shtëpia unike në Angli...

DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE

Një qershori' është dita ndërkombëtarë e fëmijëve. Fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë që sot të jenë të lumtur dhe ta festojnë këtë ditë me prindër . Kjo ditë është kthyer jo vetëm në një ditë festive, por edhe në një ditë sensibilizimi, për ti thënë jo dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve. Është dita kur vetë fëmijët hapin mushkritë për të thëne të drejtat e tyre, por në ndryshim nga të rriturit, protesta e tyre bëhet me lojra dhe festa . Dita e fëmijëve u vendos në datën 1 qershor, sepse në këtë datë është mbajtur Konferenca Botërore e Mirëqënies së Fëmijëve në Gjenevë, në 1925. Në të njëjtën ditë, koinçidoi që konsulli i përgjithshëm kinez në San Francisko mblodhi së bashku një numër të konsiderueshëm fëmijësh jetim kinezë të celebronin në festivalin e "Anijes së...

(vijon ne faqen 02)

RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

24/7 orë linjë emergjence
07878335000

Specializuar në emigracionin e Britanisë së Madhe

Main Office
190 Merton high street,
Wimbledon, London,
SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666
Gena: 07774222062

RASHID & RASHID LAW FIRM
211, The Broadway, Southall,
UB1 1NB
law768@live.com
Tel: 02086720666
Fax: 02085430534

Një minutë larg nga South Wimbledon Underground Station

...Dragoit". Dy vjet më pas Festa e 1 qershorit filloi të festohet në të gjithë botën. 1 qershori është Dita Ndërkombtare e Fëmijëve. Në Shqipëri, Kosovë dhe mbarë botën, kjo ditë u kushtohet fëmijëve, me aktivitete të larmishme. Në fakt 1 qershori e ka origjinën nga Shtetet e Bashkuara dhe Kina. Në vitin 1925 konsulli i përgjithshëm Kinez në San Francisko mblodhi së bashku një numër të konsiderueshëm femijësh jetim Kinezë të celebronin në festivalin e Anijes së Dragoit . Kjo gjë koniçidoi të ishte në të njëjtën ditë me konferencën. Festa e 1 qershorit filloi të festohet pas dy vitesh. Shumë vende të botës e kanë pranuar atë si festën ndërkombtare të fëmijëve dhe realizojnë

festime të cilat kanë si qëllim të rrisin vëmendjen në drejtim të mirqenies së tyre. Kjo ditë lumturon fëmijët dhe prinderit e tyre kur shohin se fëmijët me buzëqeshjen e tyre të ëmbël. Kjo ditë festohet në mesin e komunitetit shqiptar në BM si dita e komunitetit shqiptar dhe festë e abetares. Forumi i Bashkimit të Shoqatave Shqipëtare në Britani fton të gjithë bashkëatdhetarët në këtë ditë në Adresa: Childs Hill Park, 33 Hodford road, NË11 8NL, Golders Green në një Program kulturor artistik nga fëmijët e shkollave shqipe. Ka Valle tradicionale shqiptare, Muzike live " Triola London" me këngëtare dhe shume supriza te tjera! Te ftuar deputetë të parlamentit Britanik,kryetarë bashkish, Ambasadore dhe mjaft personalitete tjera! Hyrja falas, parkingu free! Ejani vëllezer e motra te festojme se bashku tashme ky aktivitet është kthyer në nje festë traditicionale për komunitetin tonë!

SHITET lokali "UK's Café"

Addresa:
54 Balgores Lane
Romford
RM2 6BP
United Kingdom

Email:
f11.driza@hotmail.com

CALL US
074 7525 5500



"SA Builders & Contractors Ltd"

Një nga kompanitë më të suksesshme shqiptare në Londër, ju afron me çmime të leverdishme shërbimet e mëposhtme:

- Aluminium Double Glazing Windows & Doors, Supplying & Fitting
- Aluminium Bi Folding Doors
- UPVC Double Glazing Windows & Doors, Supplying & Fitting
- UPVC Triple Glazing Windows & Doors, Supplying & Fitting
- Glass Roofs
- Roof Lanterns
- Conservatory
- Composite Doors
- Panel Doors
- All Plumbing Staff Supplies

Me çmime konkuruese

Provoni cilësinë dhe profesionalizmin tonë.

Contact:
Tel: +44(0)1708745809
Mob: 07939343712
Unit 4,
Maldon Road,
Romford,
Essex,
RM7 0JB.

SA Builders and Contractors Ltd
NICEIC APPROVED CONTRACTOR
GAS safe REGISTER

FENSA
Registered Company 34236

WIDOPAN PRODUCTS
Approved Installer

CE
SA Builders & Contractors Ltd
Unit 4 Maldon Road
Romford
RM7 0JB

“BUNARI” ËSHTË NJË NGA ROMANET E PAKËT FILOZOFIK, QË KAM LEXUAR

Protestë për Val Zeka dhe Bajraliun e Grupit të Kumanovës që u dënua me burg të përjetshëm

Nga Ilinden Spasse

Sapo mbarova së lexuari romanin “Bunari” të Fatmir Terziut. E lexova shumë shpejt, brenda natës. Për mua është një prozë poetike ku me një gjuhë të pastër e të pasur, shpesh herë edhe alegorike e filozofike, gërshetohet talenti dhe kultura e gjithanshme e autorit ... Shkrimtari me këtë roman trajton një temë sa të vështirë aq edhe të panjohur për mua. Në këtë vepër operon midis legjendës dhe realitetit, midis paganizmit dhe kohës së tanishme, moderne... Terziu përpiqet të zbërthejë copëza jete të harruara, copëza historie të harruara nga koha që ikën aq shpejt e nuk kthehet prapa, por që shpesh lë gjurma nëpërmjet folklorit popullor, gojëdhënave, përrallave, legjendave, këngëve etj. Shumë domethënës është edhe ky varg, që e përsërit, me shkak autori disa herë:



“Oh, rosa rosit na arbanosko zemlja” (Oh, vesa veson në tokën arbërore).... Në këtë roman Terziu mbështetet shumë edhe në dëshmitë arkeologjike, siç është vetë “Bunari” (pusi), siç është lumi i vogël i Ostrenit...., siç janë simbolet e ndryshme të gdhendura nëpër shkëmbinjtë, pllakat e varreve apo nëpër armët luftarake etj. etj. Në roman autori është përqendruar më tepër në familjen e Kastriotëve, flet për stemën e shqiponjës me dy kokë, për kapelen e Skënderbeut, me simbolin e bricjapit, për përkranaren e tij të veçantë dhe shpatën, që sipas gojëdhënave “ndante” shkëmbin më dysh, relikte këto që ruhen edhe sot në muzeun e Vjenës.... Në këtë roman skaliten personazhe mjaft interesantë, të shtrirë në kohë të ndryshme. Flitet për krijimin e tempujve mijëra vjet më parë, por edhe për kooperativat dhe “tufëzimin” e bagëtive, të kohëve tona moderne; për Kështjellën e “Sfetigradit”, ku Skenderbeu pesëqind vjet më parë, pësoi disfatën e madhe nga tradhëtia që iu bë, duke ia mbyllur “rubinetin” e ujit kështjellarëve por edhe për atë që tentoi të kalonte kufirin, e që u quajt “armik i popullit” i kohëve tona. Shkrimtari flet për delet e buta, që ndjekin njëra tjetrën edhe kur bien në gremina të thepisura..., por flet edhe për dhitë autoktone, që nuk bien pre si delet e urta, për simbolet e brirëve të cjepërve, që banorët i ngulnin nëpër dyert e shtëpive të tyre... për fat; flet dhe për mutacione, për ADN, për gene etj... I bëj pyetjen vetes, se ku e gjen atë forcë intelektuale, që të gërshetohet aq bukur fantazia krijuese me fenomenet e natyrës, legjendat me historinë, që të flitet për

varrin e Ançës, vajzës bukuroshe (që për mendimin tim është personazhi më i realizuar, i këtij libri...) për arrën budallaqe, qershitë e Muharremit, të trashëguar nga i ati Lamja, për hithrat dhe qershitë si bimë ushqyese dhe kurative... Me siguri, kjo ka të bëjë në radhë të parë me dashurinë që ushqehet për vendlindjen... Pa këtë dashuri nuk mund të “çahen” shkëmbinjtë, nuk do të kishte mundësi t’u jepej “gojë”, burimeve, përrenjve, fushave dhe maleve.... Zgjidhja e enigmës ku ...Prapa këtyre rreshtave personifikohet forca gjenetike e jetës, fshihet edhe forca e dashurisë së autorit për vendlindjen e tij... Një shkrimtar, nuk mund të bëhet i madh, në qoftë se në krijimtarinë e tij nuk merr personazhe nga vendlindja, nuk trajton folklorin e vendlindjes me të cilën ai është “mëkuar” që fëmijë nga tregimet, gjëegjëzat, përrallat, legjendat e gjysh-stërgjyshërve të tij, në qoftë se ai nuk është i “mbarsur” nga gurët dhe drurët e vendlindjes, nga malet, lëndinat, luginat, nga gurgullimat e ujëvarreve që i ka shkelur e dëgjuar kushedi sa e sa herë me prindërit, me shokët, me ...librat.... Pa dashurinë për vendlindjen nuk mund të jepen mesazhe të tilla të shkëlqyera si: “Duhet të dimë se me natyrën ne jemi borxhlinj, dhe jo vetëm ndaj natyrës, por edhe kohës së ikur. Koha mblidhet në një grusht germash në histori, histori të ngatërruar...” etj, etj. Autori ka aftësi të çuditshme sintetizuese: Në 123 faqe flitet për krijimin e tempujve mijëra vjet më parë, dhe për “shkatërrimin” e tyre në vitet gjashtëdhjetë; për tradhtinë që ndodhi për rënien e kështjellës së Sfetigradit pesëqind e ca vjet më parë, me “tradhëtinë” e ushtarit që kaloi klonin 30 vjet më parë... Pra me një grusht fjalësh e fjalish autori sintetizon kohën, historinë, dhe bën të flasin në 123 faqe edhe gurët, edhe lumenjtë, bën të “çahet” mali më anë të shpatës së Skënderbeut, bën të flasin edhe drurët, edhe qershitë, edhe hithrat, edhe arra budallaqe... Për mua ky është një nga romanet e pakët filozofik, që kam lexuar, e që shkrimtari e ka realizuar aq bukur, si me kompetencë shkencore, ashtu dhe me kompetencë letrare e filozofike. I lumtë. Suksese...

RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

24/7 orë linjë emergjence

07878335000

Specializuar në emigracionin e Britanisë së Madhe

Avokatët tanë të emigracionit kanë mbi dhjetë vjet përvojë në fushën e emigracionit dhe ligjit të azilit.

Çdo klient është po aq unik sa është rasti që ata na sjellin

Rashid & Rashid Solicitors, si të gjithë avokatët e tjerë në praktikë në Angli dhe Uells, është Kompani e autorizuar dhe e rregulluar nga Autoriteti i Rregullimit të Aplikantëve.

Një minutë larg nga South Wimbledon Underground Station

Për të biseduar në shqip telefono Gena:

07774222062

- Dokumente udhëtimi
- Procedura për leje qëndrimi dhe viza
- Kur jeni kotigjent per t'u riatdhesuar ose të ndaluar nga organet e emigracionit
- Mbulojmë të gjitha aspektet e emigracionit
- zgjatje vizash
- Leje pune
- Rishikim jurdik
- Apelim Tribunali
- Rastet e trashëgimisë

Main Office
190 Merton high street,
Wimbledon, London,
SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666
Gena: 07774222062

RASHID & RASHID LAW FIRM
211, The Broadway, Southall,
UB1 1NB
law768@live.com
Tel: 02086720666
Fax: 02085430534

1 QERSHORI, DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE

1 Qershori, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, tashmë është bërë traditë të festohet madhërishëm dhe nga Forumi i Shoqatave të Bashkuara në UK. Fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë sot kudo vëmendjen e prindërve, shtetit tek ata. Kjo ditë është kthyer jo vetëm në një ditë festive, por edhe në një ditë sensibilizimi, per ti thene jo dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve. Është dita kur vetë fëmijët ngrenë zërin për të drejtat e tyre, por në ndryshim nga të rriturit, protesta e tyre bëhet me lojra festive. Në Shqipëri dhe mbarë botën, kjo ditë u kushtohet fëmijëve, me aktivitete të larmishme. Dita e fëmijëve është vendosur më datën 1 Qershor, sepse nëkëtë datë është mbajtur konferenca botërore e mirëqenies së fëmijëve në Gjenevë në 1925. Në fakt 1 Qershori e ka origjinën nga Shtetet e Bashkuara dhe Kina, por nuk ka të bëjë me komunizmin. Në vitin 1925 konsulli i përgjithshëm kinez në San Francisko mblodhi sëbashku një numër të konsiderueshëm fëmijësh jetim kinezë të celebronin në festivalin e "Anijes së Dragoit". Kjo gjë koeçidoi të ishte në të njëjtën ditë me konferencën në fjalë. Festa e 1 Qershorit filloi të festohet pas dy vitesh. Shumë vende të botës e kanë pranuar atë si festën ndërkombëtare të fëmijëve dhe realizojnë festime të cilat kanë si qëllim të rrisin vëmendjen në drejtim të mirëqenies së tyre. Në këtë ditë fëmijët bëhen qendra e vëmendjes në mbarë botën dhe shumë aktivitete u kushtohen vetëm atyre. Përveçse një ditë festive, në fakt 1 Qershori duhet të jetë edhe një ditë sensibilizimi për të ndalur dhunën dhe abuzimin me fëmijët, sidomos angazhimin e tyre në punë kur janë ende të mitur. Sot është dita kur të gjithë kthejmë sytë nga fëmijët. Me rastin e festës ndërkombëtare të fëmijëve, Shoqata shqiptare në Mbretëri të Bashkuar, "Ardhmëria" në bashkëpunim me të gjitha shoqatat që operojnë në Forumin e Bashkimit të Shoqatave ka organizuar një ditë të mbushur me plot aktivitete kushtuar fëmijëve të komunitetit në një nga mjediset më të bukura dhe më të populluara me traditën dhe mirëgjetjen shqiptare, pikërisht në Childs Hill Park në Goldres Green. 1 Qershori, dita ndërkombëtarE e fëmijëve. Fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë sot vëmendjen e prindërve, të gjithë vullnetarëve për Gjuhën Shqipe në emigrim, ndihmën dhe syrin e të gjithë atyre që dinë vetëm fjalën përkushtim, vetëm sakrificë. 1 Qershori është Dita Nderkombetare e Fëmijëve. Në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni, Camëri dhe në mbarë mbarë botën, kjo ditë u kushtohet femijëve, me aktivitete të larmishme. Por ne jemi në këtë ditë të themi edhe atë që mendojmë vetëm për të qenë të bashkuar, me qëllimin të gëzojmë dhe begatojmë fëmijët tanë të lumtur. Një mirrënjohje i përcjellim Nënës Mbretëreshë, Shkëlqesisë së saj, Elizabeta II-të, për përkujdesjen ndaj nesh, shqiptarëve komunitetit më të ri në Britaninë e Madhe. Njëkohësisht edhe të gjithë miqve britanikë që na dhanë mundësinë e integrimit.



THE BALKAN
BAR & RESTAURANT

**66c Ealing Road,
Wembley,
HA0 4TH**

Salla moderne për dasma dhe okazione të tjera festive, familjare dhe shoqërore.

Kapaciteti i sallës kryesore:
150 vetë.

Kapaciteti i sallës pritëse:
80 vetë.

Shërbim profesional. I kulturuar. Modern. Çmime konkuruese.

5 minuta nga Undergroundi Wembley Central

07429459851

SKELA “JET SCAFOLDING” CILËSI, PROFESIONALIZËM, GARANCI

Skela “Jet Scafolding” tregon gjithnjë e më shumë përkujdesje në të tre elemntët e saj të suksesit. Themelet e mira janë thelbësore. Shpesh kornizat e skelave kërkojnë më shumë pllaka bazë të thjeshta për të kryer dhe përhapur në mënyrë të sigurt ngarkesën. Skela “Jet Scafolding” përdor pllaka bazë në sipërfaqe të betonit. Për sipërfaqet si trotuaret ose pllakat bazë të asfaltit janë të nevojshme. Për sipërfaqet më të buta ose më të dyshimta përdor tabela të vetme, nën një standard të vetëm, një tabelë e vetme duhet të jetë së paku 1.000 centimetra katrorë (160 in2) pa një dimension më të vogël se 220 milimetra, trashësia duhet të jetë së paku 35 milimetra (1.4 in). Për skelat e ngarkesës më të rënda mund të kërkohet shumë më tepër elementë të betonit të vendosura në beton. Në hapat e pabarabartë të terrenit që priten për pllakat bazë, rekomandohet një madhësi minimale e hapit prej rreth 450 milimetra (18 in). Një platformë pune kërkon që elementë të tjerë të jenë të sigurt. Ata duhet të jenë të ngushtë, të kenë binarët me mburojë të dyfishtë dhe të gishtin dhe të ndalojnë dërrasat. Duhet gjithashtu të sigurohet qasje e sigurt dhe e sigurt.

Komponentët themelorë të skela “Jet Scafolding” janë tubat, bashkuesit dhe dërrasat. Tuba zakonisht bëhen prej çeliku ose alumini; megjithëse ka skela të përbërë që përdor tuba të fibrave të qelqit të mbështjella me filamente në një matricë najloni ose poliestër, për shkak të kostos së lartë të tubit të përbërë, zakonisht përdoret vetëm kur ekziston rreziku nga kabllot elektrike që nuk mund të izolohen. Nëse janë çeliku, ato janë ose “të zeza” ose galvanizuar. Tubat vijnë në një sërë gjërash dhe një diametër standard prej 48.3 mm. (1,5 tubacione NPS). Dallimi kryesor midis dy llojeve të tubave metalik është pesha më e ulët e tubave të aluminit (1.7 kg / m në krahasim me 4.4 kg / m). Megjithatë ato janë më fleksibile dhe kanë një rezistencë më të ulët ndaj stresit. Tuba zakonisht blihen në gjatësi 6.3 m dhe pastaj mund të priten në madhësi të caktuara tipike. Shumica e kompanive të mëdha do t’i shesin tubat e tyre me emrin dhe adresën e tyre për të penguar vjedhjen. Bordet ofrojnë një sipërfaqe pune për përdoruesit e tribunave. Ata janë dru të kalitur dhe vijnë në tre trashësi (38 mm (e zakonshme), 50 mm dhe 63 mm) janë një gjerësi standarde (225 mm) dhe janë një gjatësi maksimale prej 3.9 m. Mbërritjet e tabelës mbrohen me pllaka metalike të quajtura pranga ose ndonjëherë pllaka gozhdë, të cilat shpesh e kanë vulosur emrin e kompanisë në to. Dyllat e tribunave të drurit në Britani të Madhe duhet të jenë në përputhje me kërkesat e BS 2482. Po ashtu, përdoret edhe stolisje druri, çeliku ose alumini, si dhe pllaka të laminuara. Përveç tabelave për platformën e punës, ekzistojnë bordet e vetme të cilat vendosen nën skelë nëse sipërfaqja është e butë ose që dyshohet ndryshe, megjithëse mund të përdoren edhe bordet e zakonshme. Një tjetër zgjidhje, e quajtur skatepad, është bërë nga një bazë gome me një pllakë bazë të formuar brenda; këto janë të dëshirueshme për përdorim në tokë të pabarabartë pasi ato përshtaten, ndërsa bordet e vetme mund të ndahen dhe duhet të zëvendësohen. Skela, e quajtur edhe skelet, është një strukturë e përkohshme e përdorur për të mbështetur ekuipazhin e punës dhe materialet për të ndihmuar në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave, urave dhe të gjitha strukturave të tjera të bëra nga njeriu. Skelat janë përdorur gjerësisht në vend për të pasur akses në lartësitë dhe zonat që përndryshe do të ishin të vështira për t’u arritur.

JET
SCAFFOLDING
LTD

Jet Scaffolding
Unit 212 Flexspace
5 Elstree Way Borehamwood
London
WD6 1SF

Tel: 0192 351 8933
Mob: 077 3874 0018
E-mail: info@jetscaffolding.com

“Skela Jet” është e bazuar në Watford, Hertfordshire dhe mbulon të gjitha zonat në Londër.

ERMAL KARAKUSHI, INXHINIERI ELEKTRIK, NJERIU HUMAN DHE INXHINIERI ELEKTRIK I RESPEKTUAR

Në fakt ishte një bisedë mjaft e thjeshtë, një komunikim njerëzor, një qasje e urtë e "muhabetit", pikërisht në hapjen e një shkolle shqipe të arsimit plotësues në Walthamstow ajo që na bëri të ulemi "këmbëkryq" me një shqiptar të mirë, një profesionist në fushën e tij, një intelektual, që menjëherë të bën për vete.

Fjalëmatur, fjalëpak dhe mjaft i ndjeshëm ndaj dhimbjes së Tjetrit. Ndërsa sheh një jetim, një fëmijë që i ati i ka ndërruar jetë nga Zoti në kohë tjetër, menjëherë i afrohet fëmijës së vet, që ka ardhur të jetë nxënës i shkollës shqipe dhe i lutet ti japë një ndihmë të vogël të cilën e bën krejt në mënyrë të fshehtë, pa u dukur dhe mjaft njerëzisht. Në Walthamstow që është qyteti kryesor i London Borough të Waltham Forest në East London, të Anglisë në atë ditë ishin edhe dhjetëra prindër shqiptarë, dhe gjithë stafi i Ambasadës shqiptare, me Ambasadorin e Shqipërisë Qirjako Qirko. Bashkia që është e vendosur 7.5 milje (12.1 km) në verilindje nga Charing Cross, kishte mjaft shushërima fëmijësh të gëzuar në atë ditë, dhe po aq thujase se fliste shqip në atë kënd ku fëmijët ishin në ditën e hapjes festive të shkollës.

Historikisht kjo minibashki që bën pjesë në qarkun e Essex, është rritur në mënyrë të konsiderueshme si pasojë e shtimit të popullsisë, si pjesë e rritjes periferike të Londrës dhe është themeluar si një njësi bashkiake në vitin 1929 para se të bëhej pjesë e Greater London në vitin 1965. Tashmë ajo ka natyrisht dhe shqiptarët e shumtë në atë zonë. Walthamstow është një qytet i madh, i vendosur në mes të Veriut dhe deri në Lee Valley dhe rezervuarin Walthamstow në perëndim, si dhe Epping Forest në lindje. Qendra e qytetit përbëhet nga pjesa e Tregut Walthamstow, tregu më i gjatë vetëm në rrugë në Evropë.

Dhe mes kësaj gjallërie biseda me këtë njeri na bëri të harrojmë kohën. Na bëri të shkojmë gjatë e gjerë në kujtesa e memorje, na bëri të rikujtojmë dhimbje e gjëra të shkuara, që hera-herës therrin dhimbjet njerëzore. Por mbi të gjitha na njohur me një njeri. Na njohu me një specialist mjaft të kërkuar. Për këtë mjafton të klikosh në goooogle dhe në fushën e inxhinierit elektrik në Britani të madhe dhe natyrisht të shënosh emrin Ermal Karakushi. Ermal Karakushi është një nga inxhinierët elektrikë më të kërkuar, më të zotë në zonën e South West e më gjerë. Ai ka vite dhe plot njëzetë të tilla që ushtron këtë profesion me mjeshtëri. Të paktën kështu thuhet në disa media britanike online.

Tashmë sa lexon në rrjetet profesionale, mëson se kur ju dëgjoni emrin Ermal Karakushi, inxhinieri Elektrik, krijoni një familjaritet që kumbon në mendjen tuaj. Ky familjaritet rrjedh natyrisht, nga profesionalizmi i tij, eksperienca që ai ka shërbyer të gjithëve klientëve për mbi 20 vjet. Ermal Karakushi ka vendosur veten si udhëheqës si një nga mjeshtrat e shërbimeve elektrike, të shërbimit profesioanl e të sigurtë dhe ka marrë përsipër detyrën e tu afrojë klientëve të tij më të aftën, të certifikuarën dhe shërbim të besueshëm elektrik, dhe të kujdeset për të gjitha nevojat elektrike.

BERISHA: NJË URIM TË PËRZEMËRT ARBA KOKOLARIT, EURODEPUTETES SË PARË SHQIPTARE...

Ish-Kryeministri Sali Berisha ka përshëndetur fitoren e shqiptares Arba Kokalari në zgjedhjet e Parlamentit Europian. "Një urim të përzemërt Arba Kokolarit, deputetes së parë shqiptare, përfaqësuese e Suedisë në Parlamentin Europian!", shkruan Berisha në Facebook duke publikuar një fotografi nga disa takime që ka pasur në vite me zonjën Kokalari. Historike! Arba Kokalari, shqiptarja e parë që bëhet eurodeputete në Parlamentin Europian Profil-Kush është Arba Kokalari, mbesa e Musine Kokalarit Historike! Për herë të parë në Parlamentin Europian do të ulet një shqiptare. Arba Kokalari, ka fituar në zgjedhjet e PE dhe do të përfaqësojë Suedinë. Kokalari, triumfoi bashkë me partinë e saj. Urime nga politika shqiptare. Ajo është 32-vjeçarja shqiptare, Arba Kokalari, e cila garoi në këto zgjedhje si pjesë e Partisë së Moderuar. Kokalari është shqiptaro-suedeze jeton në Stokholm. Ajo ka lindur në Tiranë më 27 nëntor 1986 dhe ka mbajtur postin e sekretares ndërkombëtare të grupimit rinor të Partisë së Moderuar. Kokalari garoi edhe në zgjedhjet parlamentare europaine të para 4 viteve, por nuk ia doli të fitonte. Partia e Moderuar ka fituar 17.6 % të votave, duke siguruar katër eurodeputetë, ndër ta edhe Kokalarin.

Sweet London
RESTAURANT

www.sweet-london.co.uk

62A Longbridge Road,
Barking, Essex,
IG11 8RT

info@sweet-london.co.uk

02082625172

• Ambient festiv
• Ditëlindje
• Festa
• Takime rinore
• Studentë
• Gëzime familjare

Ambient i rehatshëm për 60 vetë
Pasina komode me shisha për 50 vetë

VILA RONEL
V.R
Bar & Restaurant

Vila Ronel Bar
& Restaurant
46 Birchington Road
London
NW6 4LJ

020 7624 1385

www.vilaronelrestaurant.co.uk
Reservation@vilaronelrestaurant.co.uk

BONI
TECHNOLOGY LTD
About us
BONI Technology LTD is a Brighton based web consultancy company specializing in Web Design, Android and IOS Application Development, Search Engine Optimisation (SEO) and Social Media Marketing (SMM).
Services
Web Design
We can help you with website design, traditional printed marketing methods, social media, e-marketing and a whole host of creative design ideas.
Development
We can work together with you to define the business requirements, work out technical solutions and develop a customized software from scratch to help you
CMS Integration
We help you choose the right CMS for your business and get the most out of it. Also we help on design and development of customized CMS solutions to fit your specific needs.
Logo Design
Our Creative Department takes pride in our quick turnaround as well as the ability to interpret client ideas and turn them into unique and professional designs.
Seo & Marketing
We help business owners create fast & user-friendly websites that rank higher in search engines, which in turn helps bring more qualified potential customers
Web Support
We can fix your already created websites, redesign old style websites with contemporary design styles keep in mind and also we can help you on anything related to your online presence.
Ne Flasim Shqip
BONI
TECHNOLOGY LTD
07404 597333
info@bonitech.co.uk
bonitech.co.uk

NJËMIJË EKONOMI PËRFITOJNË NGA PROJEKTI I KEDS-IT NË PEJË

Rreth njëmijë familje dhe biznese të shtrira në zonën qëndrore të qytetit të Pejës, që nga 'Dulia' tek 'Ura e Gurit' e gjer tek Hoteli 'Gold', kanë përfituar tension stabil, energji kualitative dhe kanë shmangur rrezikun e avarive të ndryshme energjetike ndër vite.

Kjo është bërë e mundur pas projektit investiv nga KEDS-i, i cili tashmë ka përfunduar dhe është mirëpritur nga të gjithë banorët e komunitetit.

"Ne kemi kuptuar rëndësinë dhe nevojën e këtij investimi në kohë. Janë vënë rreth 40 shtylla betoni për tension të ulët dhe 1 mijë e 600 metra kabllo. Trafo poashtu ka qenë investim i mëhershëm. Ky është një investim nga i cili kanë përfituar mëse njëmijë ekonomi familjare e biznesore", deklaron zëdhënës i KEDS-it, Viktor Buzhala.

Në këtë zonë të qytetit të Pejës ka biznese të shumta dhe po ashtu institucione publike por edhe banesore, ndaj edhe ndikimi pozitiv i këtij projekti vërehet dukshëm tek të gjithë përfituesit. Njëri nga të cilët është edhe Fidan Dauti, me një biznes të vogël në këtë anë. Dauti shprehet i kënaqur me investimin e KEDS-it për të cilin thotë se ka qenë koha e fundit për tu bërë diçka para se rreziqet nga rrjeti i vjetëruar të bëheshin mëse serioze.

"Ka qenë koha e fundit për të ardhë ky investim. Puna është kryer mirë dhe ka ndiku që të na vije një furnizim stabil me rrymë. Për bizneset rryma është sikur ajri, andaj kjo që ka bërë KEDS-i është projekt që na ka ndihmuar shumë", deklaron z.Dauti.

Projekti në fjalë i KEDS-it, përfshinë disa bashkësi territoriale të qytetit të Pejës. Investime të tilla, gjithnjë sipas planit dinamik të paraparë në komunën dhe rajonin e Pejës po vazhdojnë nga Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS.

BIZNESMENI AGRON KURTAJ NA ZGJOI NJË TRADITË TË BUKUR SHQIPTARE EDHE NË LONDËR!

Natyrisht tradita është ajo që “transportohet” ndjeshëm më shumë se të gjitha gjërat në mesin e “torbave” të emigrimit. Është kjo traditë që buron nga prindërit, nga të parët e një shtëpie të quajtur me “tradita”, nga themelet ku ajo është gatuar si e tillë, të quhet traditë. C. E. Murphy është një autore amerikane e lindur që shkruan fantazi dhe romancë. Ajo është autore e serialit Ualker Papers, Trilogjia e Negociatorit dhe Cikli i Trashëgimtarit, si dhe Kronikat Strongboks të cilat ishin shkruar nën një pseudonim. Ajo gjithashtu ka shkruar romanin grafik “Take a Chance”. Por për tradita ajo na sjell këtë version në mendjen tonë nga Uban Shaman: “Në Irlandë, shkoni në shtëpinë e dikujt dhe ju pyet nëse doni një filxhan çaj. Ju thoni jo, faleminderit, jeni vërtet mirë. Ajo pyet nëse jeni i sigurt. Ju thoni natyrisht se jeni i sigurt, vërtet, nuk keni nevojë për ndonjë gjë. Përveçse ata e shpallin atë. Ju nuk keni nevojë për një pije. E pra, thotë ajo, atëherë do të bëja disa, kështu që nuk do të ishte problem. Ah, po thua, po qe se do të ishit duke marrë disa, nuk do të më pëlqente një vend çaji, për aq kohë sa nuk ka probleme dhe unë mund t’ju jap një dorë në kuzhinë. Pastaj ju kaloni të gjithë gjërat nga e para derisa të dy përfundoni në kuzhinë duke pirë çaj dhe duke biseduar. Në Amerikë, dikush ju pyet nëse doni një filxhan çaji, ju thoni jo, dhe pastaj nuk merrni ndonjë çaj të mallkuar. Më pëlqente mënyra irlandeze se është më e mira”, përfundon C.E. Murphy, Urban Shaman. Dhe kjo më shpuri në një kënd të bukur, në kopshtin e saporestauruar të shtëpisë së re të biznesmenit shqiptar, Agron Kurtaj, ku mikpritja shqiptare shkon përtej pyetjeve rutinë. Mjafton një foto e hedhur në rrjetet sociale të kuptosh se shqiptari Agron Kurtaj, jo thjesht për mikun...

(vashdon ne faqen 15)

...e përbashkët, agronomin Përparim Muça, por për mjaft të tjerë, e ka traditën me vete, e ka jo thjesht një pyetje, por një tryezë të shtruar bukur dhe këndshëm. Kjo tregon se kudo dhe kurdoherë shqiptari dallon me të tijën filozofike, se shtëpia është e mikut dhe e Zotit. Dhe kjo vjen nga shekujt. Sado të varfër të jenë malësorët, janë krenarë të presin miq. Sipas tyre, shtëpia është e Zotit dhe e mikut, ka diktuar me kohë Aleksandër Degrand Jules. Aleksandër Degrand Jules (1844-1906) ishte historian, diplomat dhe konsull i Francës në Shkodër në vitet 1893-1899. Udhëtoi kryesisht në Shqipërinë e Veriut dhe na la mjaft fotografi nga qytetet, qëndrat arkeologjike dhe natyra e bukur e vendit tonë. Fillimisht erdhi nga Ulqini në Shkodër, u habit nga gjelbërimi i saj, pemët e shumëllojshme, shtëpitë me kalldrëm, me / ardak, oxhak e frëngji. Portat e mëdha të tyre si dhe kalaja e qytetit, që janë vepra arti. I tërhoqën vëmendjen mjediset e brendshme të shtëpive, të pajisura me orendi të shtrenjta, të ardhura nga Venediku e Gjenova. Vallë shqiptarët vërtetë janë pellazgë, nga ajo racë që Homeri e quan hyjnore, pra të jenë pellazgë të mbetur të pastër dhe të papërzier deri sot, duke ruajtur gjuhën dhe shumë nga zakonet e tyre, siç dëshmojnë edhe disa autorë edhe studiues të kësaj çështjeje? Duke iu referuar autorëve të vjetër bizantinë, ai vë në dukje lashtësinë e trojeve shqiptare. Për të arritur në këto përfundime e ndihmoi njohja e kulturës së hershme ballkanike dhe e antikitetit greko-romak deri në mesjetë. Për bujarinë e shqiptarëve ai shkruan “Sado të varfër të jenë malësorët, janë krenarë të presin miq. Sipas tyre, shtëpia është e Zotit dhe e mikut.” E kështu është dhe në rastin tonë në Londër, ku një Njeri fisnik si Agron Kurtaj, natyrshëm e ka këtë preambulë mbi të gjitha dhe e transmeton krejt shqiptarisht, njerëzisht në bukurinë e saj filozofike.

Gëzuar nga mot në shtëpinë e re Agron Kurtaj, shtëpinë që na zgjoi një traditë të bukur shqiptare edhe në Londër!

Prizreni London Café

Prizreni Cafe London

Prizreni London Café është i njohur si çelësi në prodhimin e ushqimit të cilësisë dhe takeaëays, shërbime restorant, dyqan kafeje, dhe grill.

Prizreni Café me traditat më të mira shqiptare
Coffee Shop - Coffee Grill - Takeaway
Byrekë specialë
Qofte tradicionale
Pica të ndryshme

+44 2082026846

asllankureqi@gmail.com

23 Vivian Ave,
London NW4 3UX, UK

NËSE TASHMË PO DERDHET, PSE SHQETËSOHENI PËR ÇDO PIKËZ?

Njerëzit e ndjeshëm. Njerëzit e sotëm e njerëzit e djeshëm. Njerëzit e urtë, njerëzit e butë. Njerëzit që na rritën dhe njerëzit që me ta u burrëruam. Njerëzit e mirë e njerëzit e lirë. Të lirët njerëz që jetuan vetëm me fjalë. Jetuan dhe jeta krijoi një stigmë. Stigma që njerëzit e ndjeshëm janë të dobët. Në fakt sot e mot kjo stigmë duhet e duhet të zvogëlohet. Vetëm për shkak se ajo ndjen gjërat poshtë "kockave" të saj nuk do të thotë se ajo është e dobët. Ajo mbart gjithçka. nuk ndiejnë asgjë. Vërejtjet shkasin, komentet e mbajnë truallin e tyre të vrazhdë, dhe situatat e tyre të vështira lëkunden mbi lëkurën e tyre si uji gjatë një stuhie. Nëse tashmë po derdhet, pse shqetësoheni për çdo pikëz? Ky është problemi, mendoi vetë. A ka njerëz të guximshëm me të vërtetë të guximshëm? Jo. Njerëzit e guximshëm janë frikacakët e vërtetë. Në vend që të marrin përvojat dhe ndjenjat e tyre, duke i lënë ata të depërtojnë në eshtrat e tyre për t'u bërë tashmë ndodh në Pranverë! Në pranverë jeta dhe dashuria shtrihen në bar, duke xhiruar gishtat nëpër çdo thithkë sikur të ishin flokët e Tokës. Kur netët e Pranverës sjellin një fllad të lehtë, stigma imagjinon se shpirtrat po e përqafojnë atë. Në verë, kur ajo thahet, ajo përhap krahët e saj dhe shikon deri në qiell, duke ditur se çdo pikë uji që bie është Nënë Natyra që freskon lëkurën e saj me lutje. Dhe lutjet bëjnë ende efektin e tyre…, edhe për të Tjerët! Të Tjerët janë shumë të ata, stigma është e gjallë, është zgjuar, derën e saj të dollapit e ka tashmë të hapur. Ai shtrihet në shtrat dhe e pyet ankthin se si do të jetë dita, qesh me një koment të mprehtë dhe duket qartë se depresioni ka bërë shumë për jetën e tij. Gjërat që duhet ta peshonin atë, tashmë janë shprishur. Ata vijnë për ta vizituar kaq shpesh, gjithësesi në kohën kur po përgatitet për Postulatin e tij të rradhës. Dhe dera e mbyllur nuk hapet më. Forca që duhet për të mbajtur derën

Ndjenjat e saj, ndjenjat e njerëzve të mirë, njerëzve të lirë, njerëzve të tjerë, bota rreth saj është shpërngulur pa pashaportizim, ndërsa ajo, pra bota e mistershme ngadalë e ngadalë i merr të gjitha. I merr të gjitha me një të telefonuar, me një Watsapp, me një Viber, me një Mesazhier, me një fjalë… që prodhon dhimbje e mall. Aty stacionohet ndjeshmëria. Ndjeshmëria u konsideroka e dobët?! Njerëzit e tillë janë ata që konsiderohen të guximshëm, apo jo? Ata kanë duruar aq shumë sa që palca që i nxit trupat e tyre, i mbyllin dhe i bëjnë skelete në një dollap. Ata janë ngatërruar me bagazhin që ata mbajnë në kurriz. Dhe janë bërë palë të mpiksjes gjithnjë e më shumë. Ju a përsëris! Nëse tashmë po derdhet, pse shqetësoheni për çdo pikëz? Një botë që mbeti e lagur me lotë, me lotë emigrimi, ikjesh e ikjesh, një botë që mbeti në ujëra të ftohtë … ujëra të dhimbshme. Njerëzit rreth kësaj po jetojnë vetëm në këtë botë … Njerëzit e ndjeshëm, o njerëz të ndjeshëm vendosni, ndërkohë që po e absorboni atë. Kjo shqetësuar duke u siguruar që skeletët e tyre të mos dalin nga dollapi. Forca, në fund të fundit, është aftësia për të përballuar sasi të mëdha të presionit dhe Perëndia e di se sa forcë duhet të mbajnë këto skelete. Është sikur po bisedojnë me veten kur në realitet Ai edhe kur shkruajti Postulatin e tij të Pestë, duket qartë se bisedon me skeletet e tij. Mos prisni natë, mesnatë, pas mesnatë. Pas mesnatës, kur të tjerët janë zhvendosur për të fjetur, duke shpresuar që skeletet e tyre të mos vijnë për t'i ndjekur mbyllur është e pamund. Megjithatë, Ai merr një sasi të dozës së përditshme, dhe teksa duket se ende ka guxim për të hapur dollapin e tij, pa u frikësuar nga gjërat që mund të hidhen jashtë në tërë këtë amulli qesh me veten e tij. Qesh ashtu i përlagur. Dhe ndjek pikëzat me numra që qafohen e bien rreth lëkurës dhe skeleteve të të vetëve… habitet! Fundja për herë të parë ndodh njerëzisht në skeletet e tij: Nëse tashmë po derdhet, pse shqetësoheni për çdo pikëz?

SHOQATA KULTURORE ALBABELL

Është laboratori i integrimit të përsosur mes dy komuniteteve.

Fjalia e parë e një termi tashmë të njohur në të gjitha gjuhët, atë që në shqip paraqet njohjen të bën me të vërtetë të shkosh më tutje, më larg, të qëndrosh më gjatë me "Albabell". "Albabell"! Një emër dhe një angazhim që lidh me ura kulturore dy komunitetet, dy vende, dy tradita, dy risi të reja. "Albabell" është pra dashuria, respekti, integrimi, përkuhstimi dhe mbi të gjitha sikurse thuhet në atë fjali të parë është: "laboratori i integrimit të përsosur mes dy komuniteteve!" Pra, është laboratori i integrimit të përsosur mes dy komuniteteve, Qendra Shqiptare e Kulturës, e themeluar nga një grup intelektualësh, operatorësh të kulturës dhe sektorit të tretë, që synon të përhapë njohuritë mbi historinë dhe kulturën e Shqipërisë në Provincën Belluno, të Italisë, të nxisë integrimin e komunitetit shqiptar dhe të nxisë zhvillimin e marrëdhënieve kulturore, sociale dhe institucionale midis dy vendeve. Sipas themeluesit të saj dhe drejtuesit kryesor të saj, Inxhinierit Artan Shyti, e gjitha ka ndodhur nga "dëshira për të grumbulluar burimet dhe përvojën shumëvjeçare të disa vëllezërve. Qendra është aktualisht e pranishme me selinë e saj në Belluno, por synon të kryejë veprimtarinë e saj edhe në komunat e tjera në provincën Belluno, gjithmonë në bashkëpunim dhe me përkrahja e komuniteteve lokale." Më tej duke shkuar në brendësi të misionit të kësaj organizate mësojmë se "Në kryerjen e veprimtarisë së saj, Qendra - synon të përfitojë nga mbështetja dhe bashkëpunimi i organizatave të ndryshme, publike dhe private, në Itali dhe Shqipëri. "Albabell" shfrytëzon përfshirjen aktive të përfaqësuesve të shquar të botës akademike, kulturore dhe letrare shqiptare dhe punën e shumë vullnetarëve. "Albabell" planifikon rrugë ndërkulturore duke respektuar prioritetet dhe jetën e përditshme. Drejtuesit e kësaj organizate shtojnë se "Ne jemi të bindur se duke filluar nga më të voglat është e mundur të krijohen hapësira fizike dhe sociale të dialogut ndërkulturor, duke realizuar veprime të socialitetit që favorizojnë një klimë të favorshme për dialogun ndërkulturor dhe ofrojnë mundësi për thellim dhe mundësi për njohuri nëpërmjet artit, kulturës, formave narrative , multimedia. Është një ndjenjë e përhapur se rrugët sociale midis të rinjve me origjinë italiane dhe të huajve të rinj, në shumë raste të lindura në Itali, ndjekin një rrugë të përbashkët në ciklet e shkollave fillore dhe pastaj përhapen nga shkolla e mesme, shpesh duke shkaktuar grumbullime sipas kombësisë ose zona e origjinës së të rinjve ose prindërve". Dhe kur flasim për drejtuesit, ata janë të gjithë intelektualë dhe të mirëintegruar në jetën italiane, duke filluar nga Presidenti dhe themeluesi Artan Shyti, i lindur në Elbasan në vitin 1964. Diplomë në Inxhinierinë e Materialeve nga Universiteti i Tiranës në vitin 89 dhe i njohur në Universitetin e UNIPM Marche në vitin 2011. Përgjegjës për R & D (kompani fotovoltaike). Konsulent ndërkombëtar për panelet fotovoltaike. Armand Bajraktari, zëvendëspresident dhe themelues, i lindur në Korçë në vitin 1983. Ka diplomuar në Shkencat Teknike të Aktiviteteve Motorike të Adaptuara dhe

Parandaluese, në vitin 2010 mori Universitetin G. D'ANNUNZIO CHIETI-PESCARA. Profesor në Zyrën Provinciale të Shkollës Belluno Provincial Trainer për CO. Sindi Manushi, Sekretare dhe themeluese, e lindur në Elbasan në vitin 1992. Ka diplomuar në drejtësi në Universitetin e Trentos. Ajo bashkëpunon me disa firma ligjore në Provincën Belluno. Ismail Mema, Këshilltar dhe themelues i lindur në Elbasan (ALB) në vitin 1973. Ka diplomuar në Matematikë-Fizikë në Universitetin e Elbasanit. Punëtor në sektorin e ftohjes. Arjana Danaj, Këshilltare dhe themelues elindur në Kukës (ALB) në vitin 1971. Diplomë në analiza kimike në Institutin e Lartë të Elbasanit. Operatori socio-sanitar. Shqipe Buduri, Këshilltare dhe themeluese. E lindur në Mirditë në vitin 1981 Diplomë Master në Institutin e Lartë të Mirditës. Punonjës social-shëndetësor. Hajri Memoci, këshilltar dhe themelues, Lindur në Shijak në vitin 1962. Diplomë inxhinieri mekanike. Punëtor metalik-mekanik. Dhe të gjithë këta emra themelues të organizatës dhe drejtues të saj u bënë bashkë si fillim për të ngjizur një emër. Një emër që ka të bëjë me organizatën që tashmë ata kanë pasion. Dhe ai ishte "Albabell" Emri "Albabell" është zgjedhur si një simbol i bashkimit midis komuniteteve shqiptare dhe Bellune, një fillim të ri, një epokë të re që përballet me të ardhmen pa harruar të kaluarën. Organizatorët dhe drejtuesit e kësaj organizate theksojnë "Është zgjedhur si Lindja, Primordiale e një bote të re: Nga shëndeti dhe bukuria psikofizike-fizike, pa lënë pas dore kënaqësinë dhe kënaqësinë e vetë Vetë. ALBA është periudha e ndërmjetme ndërmjet natës dhe ditës së plotë. Fillon në dritën e parë të ditës, momenti i quajtur edhe agimi, duke kulminuar me agimin dhe duke përfunduar me ngritjen e Diellit, momenti në të cilin buza e diskut diellor shfaqet mbi horizont". Duke qenë se një nga vizionet e tyre është "Një Jetë e Gëzuar në Integrimin e Diversitetit, në një Planet Prosperues" dhe ne u urojmë mbarësi dhe suksese në misionin e tyre.

SHTËPIA UNIKE NË ANGLI, JA PSE TURISTËT MBESIN TË MAHNITUR

Shtëpia unike në Angli krijon një përshtypje të veçantë për vizitorët, të cilët pasi futen brenda saj kthehen me kokë poshtë. E quajtur "Upside Down", që qëndron në çatinë e saj, është ide e inxhinierit Tom Dirse. Shtëpia unike është ndërtuar për të siguruar një mundësi të re për të bërë fotografi. "Ne duam që ajo të jetë sa më realiste që është e mundur. Ndërsa kur realizojmë fotografi, ndihemi sikur jemi në shtëpinë e dikujt", thotë Dirse. Vizitorët mund të shihen duke qëndruar në tavan, duke mbajtur mobiliet, duke shikuar nga dritarja ose duke shkuar në tualet. Fotografitë e tyre shpërndahen masivisht në rrjetet sociale, pasi vetë ambienti dhe shtëpia ku shkrepen ato, e bëjnë një kujtim të paharrueshëm dhe të veçantë. Kompania që e ndërtoi këtë shtëpi, tani numëron 4 të tilla. Një shtëpi e tillë kaq tërheqëse, për të parën herë, u ndërtua në fund të vitit 2018 në Bournemouth, një vendpushim bregdetar në bregun jugor të Anglisë. Shtëpitë ndryshojnë me stinët si brenda ashtu edhe jashtë saj. Turistët nga e gjithë bota marrin me vete kujtimet e bukura nga kjo shtëpi me stil të veçantë arkitekturor.

Është e reja e saj që kthen kokat në Bournemouth.

Një shtëpi me dy kate me kokë që ulej në çatinë e saj hapi dyert e saj në Triangle të shtunëne javës së parafundit të majit. Struktura ka qenë nëntë muaj në bërjen e ngjarjeve të kompanisë Upside Down House UK dhe kjo është hera e parë që shtëpia është parë në Britani. Të gjitha dhomat kanë mobilje dhe pajisje të jetës reale, të cilat janë të siguruara në mënyrë të sigurtë në tavanet, dhe ka edhe një palë pantofla që janë mbërthyer me kokë poshtë. Brenda ka dy dhoma gjumi, një sallë pritjeje, kuzhinë, një banjo dhe një zyrë. Midis mobiljeve tavan të lartë është një ahur, një tualet, një tavolinë dhe një shtrat. Ideja e shtëpisë është që vizitorët të marrin fotografi normale të njëri-tjetrit brenda dhe më vonë të rrokulliset fotot 180 gradë për ta bërë atë të duket sikur edhe ata janë të përmbysur. Do të mbetet në vend deri në qershorin e ardhshëm. Upside Down House UK kanë marrë frymëzim nga një tërheqje e ngjashme në vendbanimin e përhershëm në Lituani. Tom Dirse, CEO i Upside Down House UK, tha: "U afrua nga njeriu që tani është partneri im i biznesit për të sjellë një shtëpi me kokë në Britani." Ai ishte pas tërheqjes në Lituani dhe pas

rreth nëntë muajve të punës ne kemi arritur ta marrim këtë hapur në Bournemouth. "U deshën rreth 11 ditë për të ndërtuar dhe reagimi i hershëm ka qenë tepër pozitiv. "Është diçka shumë e ndryshme dhe njerëzit duken vërtet të ngazëllyer nga kjo. "Është bërë prej druri dhe përshtatet së bashku pothuajse si një projekt i madh Lego. Ai shtoi: "Ju mund të thoni se është e re dhe deri më tani ne jemi të kënaqur me mënyrën se si reagojnë njerëzit". Brenda dhomave janë të gjitha dru të pastër, por Dirse tha se një projektuesi në shtëpi do të punojë vazhdimisht për të mbajtur pamjen e freskët. Z. Dirse shtoi: "Pas shtatë muajve fillestar është shumë e hapur për atë që ne bëjmë, por do të donim të gjenim një shtëpi më të përhershme këtu". Tërheqja është e hapur ndërmjet orës 10 dhe 7 të hënë deri të premten dhe nga ora 10 deri në orën 21 në fundjavë. Hyrja kushton £4 gjatë ditëve të javës dhe £5 të shtunën dhe të dielën.

GRUPSEKSIONI NË ZONËN BARKING DHE DAGENHAM NË LONDËR FORCË MBËSHTETËSE E PD LONDËR

Nga Gazmend Cufaj

Inderuar Lideri i Opozitës Shqiptare, Kryetari i PD-së dhe shpresës demokratike të sotme, Kryeministri i shpresave të mëdha shqiptare, Z Lulzim Basha!

Grupseksioni që drejtoj unë në zonën Barking dhe Dagenham në Londër ka kohë që ka miratuar lëvizjen e madhe mbështetëse të PD-së në protestat e mëdha dhe masive në Atdhe. Ashtu sikurse shqiptarët anë e mbanë vendit i janë bashkuar fuqishëm tashmë Partisë Demokratike dhe ne të gjithë jemi me ta dhe jemi të gatshëm të bëjmë sakrificën më të madhe për të qenë aty me popullin shqiptar në të drejtën e tij. Protestat e thirrura nga opozita kanë gjetur mbështetjen e fortë të anëtarëve të Grupseksionit dhe mbështetësve të shumtë, të cilët tek thirrjet e Juaja dhe drejtuesve të tjerë aleatë gjejnë kauzën e tyre, atë të braktisjes prej kësaj qeverie dhe vënies së saj në shërbim të krimit!

Demokratët e këtij Grupseksioni, kuptojnë qartë se të afërmit e tyre sot ndihen absolutisht të harruar nga Rilindja kudo ku ajo qeverisë në nivel qendror apo lokal, ndaj dhe ka vendosur të reagojë fuqishëm kundër padrejtësive, një qeverie bandë siç e konsideroni Ju i nderuar Kryeministri i ardhshëm i Shqipërisë demokratike. Mosmbajtja e asnjë premtimi, mosllogaridhënia, i ka çuar drejtuesit e qeverisë drejt arrogancës së pashembullt duke mos i konsideruar aspak shqiptarët dhe duke mos u dhënë asnjë shpresë dhe emigrantëve si ne.

E habitshme është, por arritëm deri në këtë pikë. E nisën rilindasit e Ramës, siç duket përmes një projekti që kishte të bënte me ndërtimin e një shteti policor, si dhe forcimit të mafies për ta përdorur për qëllime elektorale. Ne e ndjejmë dhimbjen shqiptare. Ne jemi për mbështetje totale të PD dhe të vendimve tuaja.

Urojmë që sa më shpejt të shohim dritën e duhur nga ky tunel errësire në Atdhe!

NJË SHËTITJE PËRMES MBREKULLIVE TË TIRANËS

Nga Sejdo Harka

Sapo dëgjon vargjet brilante të këngës qytetare tiranase “Ku ka si Tirana…”,para sysh,si në një ekran gjigand, të shpalosen konturet e një qyteti, sa të lashtë ,aq dhe të ri, me një bukuri mahnitëse.Ky qytet është Tirana,kryeqendra e ekonomisë dhe zhvillimit,e kulturës dhe arsimit, promotorja e zhvillimit të gjithanshëm të Shqipërisë.Mjafton vetëm pyetja retorike pohuese:”Ku ka si Tirana”,për të kuptuar se në vendin tonë, nuk ka qytet tjetër të dytë si ai.Tirana është e papërsëritshme,jo vetëm për pozicionin gjeografik,por edhe për infrastrukturën e saj dhe gjelbërimin,për arkitekturën dhe bukurinë e saj të papërsëritshme.Tirana,ose siç quhet ndryshe,zemra e Shqipërisë,e shtrirë në Ultësirën Perëndimore të vendit tonë,gati e baraslarguar nga të katër pikat e e horizontit të hartës së saj,kufizohet me Durrësin dhe Elbasanin,me malin e Dajtit dhe gjerdanin e kodrave të bukura të Kamzës dhe Yzberishtit,të Vaqarit dhe Saukut,të cilat i rrinë asaj mbi krye si kurorë e artë,nga kreshtat e të cilave të fanepsen majat e kalave të lashta mesjetare, si ajo e Petrelës dhe e Prezës,e Dorëzit, Përsqopit dhe e Tujanit.Po ta vështrosh Tiranën nga lartësitë e Dajtit , herë i ngjan nje cope qielli shumëngjyrësh,i zbritur si me dorë nga vetë Zoti,dhe herë,sidomos mëngjeseve,si një pus i frikshëm,mbuluar me re të zeza smogu, si frut i hidhur i njeriut të papërgjegjshëm dhe” vetvrasës”. Tirana,ky qytet i bukurive përrallore,njëkohësisht është dhe vendi i diferencave dhe kontrasteve të mëdha ekonomike dhe shoqërore ,politike dhe social-kulturore,fatkeqësisht me një trend thellimi,gjithnjë e më të madh,gjë që ndikon ndjeshëm për thellimin e mëtejshëm të polarizimit shoqëror dhe politik të vendit.Ajo është qyteti i lirisë dhe i ëndrrave,i luftës dhe barrikadave,qyteti i rrëmujës dhe i rrëmetit,i stresit dhe i qejfit;qyteti, ku njerëzit e punës,siç thuhet dhe në vargjet e një parodie qytetare “shtypen nga mashtruesit e mercenarët/prokurorët dhe gjyqtarët”dhe“Qeveritë që s’bien nga froni”.Tirana është, sa e qetë dhe e dlirë, aq dhe “e çmendur dhe e mpirë”.E megjithatë,tiranasit nuk e ndërrojnë atë me asnjë qytet tjetër.Ndaj i këndojnë asaj me vargun brilant e kuptimplotë :”Si do që të jesh ,ti je e jona”.

-Në gjurmët e Tiranës së hershme Për Tiranën janë thurur jo vetëm qindra këngë e poezi,por janë shkruar e botuar edhe shumë libra e studimenga studjues e publicistë të spikatur si Kristo Frashëri,Osman Myderizi,… dhe gazetarja Rezarta Delisula, e cila kohët e fundit ka botuar albumin”Tirana mahni”.Sipas Kristo Frashërit dëshmitë e ekzistencës së shoqërisë njerëzore në këtë trevë i tokojnë Paliolitit të vonë.Themeluesi i Tiranës së hershme është Sulejman Pashë Bargjini,me orgjinë nga Mulleti,që në vitin 1614.Por emri Tiranë,për herë të parë është përmendur në dokumentat e Venedikut, që në vitin 1408.Versionet e prejardhjes etimologjike të emrit të këtij qyteti janë disa,por ne po përmendim vetëm dy prej tyre.Sipas gojdhënave ,emri “ Tiranë” ,mund të ketë ardhur nga emri i pijeshitësit Tyrhan,i cili në vitet 1460-70,menjëherë pas vdekjes së Skënderbeut,shiste pijet e tij të preferuara për banorët e këtyre anëve. Versioni i dytë është se emri i kryeqytetit tonë të sotëm mund të ketë ardhur nga emri i kështjellës mesjetare Tyrhanos,emër që me kohë ka evoluar në”Tiranë”.Si qendër e madhe tregëtare e Shqipërisë ,Tirana,e atyre viteve,do të bëhej mollë sherri midis sundimtarëve më të zëshëm të kohës, siç ishin Ibrahim Pashë Bushati dhe toptanasit e Krujës,të cilët,sidomos këta të fundit ,i sollën Tiranës një zhvillim të kënaqshëm për kohën.Ky zhvillim do të marte një hov të ri ,veçanrisht në fillimin e viteve 1900 .Që në vitin i905, Pazari i Vjetër i Tiranës kishte 480 dyqane të rikonstruktuar.Në këtë qytet,më 26 Nëntor të vitit 1912 u ngrit Flamuri i Pavarsisë,dy ditë para se të ngrihej në Vlorë. Më 21 Janar 1920,Kongresi i Lushnjes e shpalli Tiranën kryeqytet të përkohshëm të Shqipërisë,ndërsa më 11Shtator të vitit 1820, Asambleja Kushtetuese e shpalli atë kryeëytet të përhershëm,ku do të vendosej për gjithnjë edhe selia e qeverisë së Sulejman Delvinës. Si rezultat i marrdhenjeve të mira, që kjo qeveri krijoi me Italinët, infrastruktura e Tiranës,pësoi transformime të madha,me frymëmarrje të thellë evropjane.Vitet 1925-40,ishin vitet e ndërtimit të kompleksit të ministrive dhe i kryeministrisë,ndërtimi i godinave të Presidencës dhe Akademisë së Shkencave,me një arkitekturë moderrne .Që në ato vite Tirana kishte 3 gjimnaze dhe rreth 130 mijë banorë. Me bukurinë dhe pastërtinë e rrallë të Tiranës,të huajët janë mahnitur,që kur ajo hidhte hapat e para të qytetërimit.-Kur u nisa për në Tiranë-trgon një turist i huaj, në vitin 1850-mendoja se do të shihja një çerdhe të errët ,të mbuluar me papastërti,por në fakt,vazhdon ai, gjeta një qytet të pastër,të shtrirë në një fushë plot kopshte e pemë,ku askush nuk vuante për bukë.Është vërtet një çudi e rrallë, që Shqipqria e viteve 30,paskësh patur fatin të bëhej protagonist i Librit Gines për numrin e madh të aerodromeve, jo vetëm në Tiranë,por dhe në shumë qytete të tjera të vendit. Edhe pse kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së mundësive të tjera për trasportin e udhëtarëve,është një mbrekullie rrallë të mendosh se shqiptarët kanë mundur të fluturojnë kaq shpejt me aeroplan ,jo vetëm brenda vendit,por dhe jashtë tij.Rrugën e ndriçimit elektrik,Tirana e ka nisur që në vitin 1927, me një central të vogël,për të bërë një rrugë të gjatë drejt ditëve tona me centrale e hidrocentrale moderrne.

STAD I RI I ORGANIZIMEVE KOMUNITARE NË BRITANI TË MADHE

Nga Fatmir Terziu

Organizimi i Komunitetit shqiptar në Mbretëri të bashkuar tashmë ka hyrë në një stad më profesional, më të pavaru, më të ndërgjegjësuar në misionin e tij real. Kështu në plan të parë shihen veprimet e organizuar të kohëve të fundit të shoqatave shqiptare "Mother Tereza – Albanian Union" që drejtohet nga Dr Zamira Përfundi Ruspi, shoqata shqiptare "Peja", që drejtohet nga Nevzat Agolli, Shoqata "Arbëria" etj. Shoqata "Mother Tereza – Albanian Union" është parë duke vizituar famije të cilat kanë pasur arsye të ndjeshme integruese në BM, ose më saktë kanë qenë bërë pjesë e një gëzimi të madh familjar, që lidhet me banesën personale. Ndërkohë shoqata shqiptare "Peja" ka organizuar së fundi Turnirin e përvitshëm të Futbollit në ndihmë të komunitetit dhe humanizmit që kjo shoqatë bën dhe rezervon për njerëz dhe komunitetet në nevojë në Atdhe. Shoqata "Arbëria" është në përgatitjet e Ansamblit me të njëjtin emër që do të jetë pjesëmarrës në "East European Fair" ku do të festohet Kultura dhe Trashëgimia shqiptare mes disa kulturave të tjera. Ky eveniment që përgatitet në Forty Hall, Forty Hill, EN2 9HA natyrisht ka thirrje masive për vëzhgim komunitar. Shoqata "Arbëria" është ftuar të përfaqësojë komunitetin shqiptar duke performuar me vallet dhe veshjet e bukura shqiptare. Kështu Shoqata "Peja" në Randolph Avenue, Maida Vale, London W9 1PD e ktheu të dielën e sotme festive në sportivitetin e turnirit. Aty nuk munguan dhe ushqimet tradicionale shqiptare të përgatitura nga amvisat shqiptare të shoqatës. Më tej zonjat e "Mother Tereza – Albanian Union" krahas aktiviteteve të shumta komunitare dhe organizimeve efikase me komunitetin shqiptar natyrisht tregoi dhe respektin dhe festimin ndryshe duke u bërë palë e gëzimit me Tjetrin. Natyrshëm kështu kuptojmë atë që çfarë do të thotë organizimin komunitar. Pra, sikurse dihet tashmë organizimi i komunitetit i referohet organizimit që synon të bëjë përmirësime të dëshiruara për mirëqenien shoqërore të komunitetit dhe funksionimin e përgjithshëm. Organizimi i komunitetit ndodh në komunitetet që bashkohen dhe afrohen gjeografikisht, psikosocialisht dhe ose në mënyrë digjitale. Organizimi i komunitetit është sinonim me punën në komunitet, zhvillimin e komunitetit, fuqizimin e komunitetit, si dhe mobilizimin e komunitetit. Ky është një model i zakonshëm për organizimin në organizatat me bazë komunitare, jofitimprurëse, shoqatat vullnetare, rrjetet sociale dhe projektet e komunitetit, të cilat mund të veprojnë si mënyra për të mobilizuar rreth gjeografisë, hapësirës së përbashkët, përvojës së përbashkët, interesit, nevojës dhe ose shqetësimit komunitar, si dhë gëzimeve e aktiviteteve kulturore, sportive, apo dhe ato personale e familjare. Organizimi i komunitetit është një proces me të cilin një komunitet identifikon nevojat ose objektivat, ndërmerr veprime dhe përmes këtij procesi zhvillon qëndrime dhe praktika bashkëpunuese dhe bashkëpunuese brenda një komuniteti. (Murray G. Ross, 1967). Kjo duket qartë me aktivitetet e tashme të këtyre shoqateve që cituam më lart. Organizimi i komunitetit është i diferencuar nga organizimi i komunitetit të orientuar drejt konfliktit, i cili fokusohet në ndryshimet afatshkurtra, duke u fokusuar në ndryshimet afatgjata nëpërmjet organizimit të komunitetit. Kjo shpesh realizohet përmes përfshirjes, bashkëpunimit, pjesëmarrjes, edukimit popullor, dhe demokracisë së drejtpërdrejtë. Brenda organizatave, ka shumë ndryshime në aspektin e madhësisë dhe strukturës organizative. Disa janë të përfshira zyrtarisht, me një kushtetutë të shkruar dhe një bord të drejtorëve (i njohur edhe si një komitet), ndërsa të tjerët janë shumë më të vogla, joformale dhe grasroots. Por kjo tashmë është bërë moto më vete në organizimet e shoqateve të tilla si "Mother Tereza – Albanian Union"; shoqata shqiptare "Peja" e të tjera. Evolucioni i kohëve të fundit i organizimit të komunitetit, ka forcuar qëndrimin se këto organizata "nga poshtë lart" janë më efektive në adresimin e nevojave lokale sesa organizatat bamirëse burokratike më të mëdha, si dhe organizimin afatshkurtër me strategjitë. Shumëllojshmëria e institucioneve, grupeve të interesit dhe grupeve të aktiviteteve nuk përcaktojnë domosdoshmërisht organizimin e komunitetit. Faktorët si ndërveprimi, integrimi dhe koordinimi i grupeve ekzistuese dhe aktiveve, aktiviteteve dhe marrëdhënieve, evoluimi i grupeve dhe institucioneve të reja, janë karakteristika unike për organizimin e komunitetit. Në këtë rrugëtim është dhe shoqata e Brightonit me z Hysen Perlesha. Duke parë se Organizata e komunitetit njihet të çojë në kuptueshmëri më të madhe të kontekstit të komunitetit dhe karakterizohet nga ndërtimi i bashkësisë, planifikimi, veprimi shoqëror dhe mobilizimi, promovimi i ndryshimit të komunitetit dhe përfundimisht ndikimi në sistemet më të mëdha shoqërore. Organizatat e komunitetit në përgjithësi janë jo-fitimprurëse dhe financimi shpesh shkon direkt drejt mbështetjes së aktiviteteve të organizatës. Prandaj shihen më kuotimplote organizimet e tila nga "Mother Tereza – Albanian Union"; shoqata shqiptare "Peja", "Arbëria", "Brighton" etj.

GJEJINI FIGURAT E FSHEHURA

Koha e fillimit _____:_____
Koha e mbarimit _____:_____
Koha e zënë _____:_____

Gjejini të gjitha figurat që janë të paraqitura në foto!



SUDOKU

Koha e fillimit _____:_____
Koha e mbarimit _____:_____
Koha e zënë _____:_____

SUDOKU I MESEM

	5			6	8	1		
2	6							8
1					9	2	5	
	1				6			
5		3		1		6		7
			4				1	
	2	1	7					5
9							8	4
		6	8	9			2	

SUDOKU I LARTË

3	6		1	4		2		8
4					9	5		
	7			8		6		4
2			5					
7						1		3
8			4					
	3			2		9		5
5					3	8		
9	8		6	5		3		2

FJALËKRYQI

Koha e fillimit _____:_____
Koha e mbarimit _____:_____
Koha e zënë _____:_____

	Këngëtarja në foto, Hadergjonaj	Banori i krahinave të larta malore	Tokë që lërohet e mbillet, tokë buke	Bimë e vendeve të nxehta	Që merret me art (shq.)	Njeri shumë dorështrën-guar	Vendos Tempo, Azoti		Radio Televisioni Italian
Lloj i veçantë gjipsi shumë i bardhë									
Që është me shumë fytyra, laragan								Atomi Populli që banonte në pellgun e Egjeut	
Që i lë punët zvarrë							Thith me gojë Shumta		
➦			Nëpunës i ngarkuar pranë një përfaqësie diplomatike						Pjesë e syrit
Menjëherë Radiumi			Secila nga të dy kockat e fytyrës (shq.) Shpuzore						
➦						Vend në Iran Sëmundje e rëndë			
Diçka e panjohur Spanja		Amperi Gruaja që punon bulmetin		Emër mashkulli (shq.) Persi					
Lloj sëpate me teh të gjerë (shq.)	Mjet për të rrëshqitur mbi bor Mjet				Intensiteti Lumë në Austri		'Goldman Sachs'		
➥									
Patok									
➦					Barabar për të dy palët				
Ligj Loj gruri i shkurtër				Fosfori Natriumi					
Fusha ku zhvillohet një përleshje									
Tetova			Njeri i fuqishëm e i shkathët						

SUDOKU

Koha e fillimit _____:_____
Koha e mbarimit _____:_____
Koha e zënë _____:_____

SUDOKU I MESEM

1		6		4		5		9
2				3				4
		9	6	8	5	3		
		4		9		8		
5								6
			8		2			
7								8
	2						5	
8	4			2			6	3

SUDOKU I LARTË

3	4	6		5		1	9	8
2								6
4								1
	9		1	7	2		6	
			7		9			
7	2	4				9	1	5
9	3	8	5	1	4	6	2	7

SKANDI-V, ALABASTËR, LARAMAN, A, BRANAR, PI, FËT, ATASHE, RA, NOFULLI, MISTER, MAR, E, A, ILAZI, SKI, I, GS, SATËRI, PATAN, KANUN, ROK, P, ARENA, TE, AT.

DAILY FRESH HALAL MEAT AND FRUIT
HILAL FOOD CENTRE
International Food Centre
318-324 Kilburn High Road,
London, NW6 2QN
020 7372 1059
VEAL SPECIAL OFFER